

# TRAFIKIMI I NJERËZVE

## Hyrje

Trafikimi i njerëzve është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut! Shkelja e këtyre të drejtave themelore meriton ndëshkimin më të ashpër, por për të shëruar plagët e kësaj mizorie e cila jo gjithnjë kuptohet me lehtësi nga të afërm, familjarë, etj, të cilët padashur influencojnë në ritrafikimin e viktimave, shoqëria civile por edhe shteti e ka për detyrë që të edukojë dhe të lehtësojë dhimbjen e shkaktuar prej këtyre veprimeve makabre të njeriut kundër njeriut në kohën moderne.



Qëllimi i këtij aktiviteti është që të ndërgjegjësojë për të parandaluar dhe të luftojë përmes shoqërisë civile dhe ndërgjegjësimit të organeve kompetente fenomenin e trafikimit të njerëzve në përgjithësi dhe të fëmijëve dhe grave në veçanti.

## FAKTE

Miliona njerëz trafikohen çdo vit përmes kufijve ndërkombëtarë. Shumica e tyre janë “GRA DHE FËMIJË”. Në listën e këtyre vendeve ka kohë që është renditur edhe vendi ynë. Fillimisht trafikimi ishte një fenomen i panjohshëm edhe nga shoqëria edhe nga legjislacioni. Kur ai hyri mire tek ne filloi reagimi. Ende sot ka shfaqje që tregojnë se niveli i ndërgjegjësimit është shumë i ulët.

- Përshkallëzimi global i fenomenit
  - 500.000 - 2.000.000 çdo vit janë viktima të trafikimit
  - Një treg global: kërkesa dhe oferta
- Trafikimi për shfrytëzim seksual është vetëm një pjesë e trafikimit
- Fëmijët si viktima janë gjithashtu të ndikuara nga trafikimi
  - Trafikimi është i lidhur me forma të tjera të krimit të organizuar
  - korrupsionin

Pse ekziston trafikimi i njerëzve?

Sepse është “biznesi” më fitimprurës. Statistikat botërore flasin për shumta marramendëse që vijnë nga trafikimi i njerëzve.

Pse përdoren të trafikuarit?

**Për prostitucion**  
Për punë të detyruar  
Për përfshirje në krim të organizuar  
Etj.

Pse ende ekziston trafikimi?

**Gjendja ekonomike është e vështirë, papunësi dhe arsim i pakët**  
Disa kërkojnë të ribashkohen me familjet në emigracion  
Disa duan ti shmangen luftës dhe konflikteve civile  
Persekutimit etnik  
Premtim për kushte më të mira



Si realizohet rënia në rrjet?	Me dhunë fizike dhe seksuale, mashtrime, frikë Korrupsioni ndikon gjithashtu Kërcënime reale Pastrim i parave gjen këtu strehë komode Shmangia e taksave
Ligjet në fuqi	<p><b>Konteksti ligjor</b></p> <p>Trafikimi i grave dhe femrave përmes kufijve për qëllime të shfrytëzimit seksual është formë bashkëkohore e skllavërisë dhe paraqet shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Ligji penal shqiptar dhe Konventat e ratifikuara nga vendi ynë janë instrumentet bazë që ndëshkojnë këtë veprimtari.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Kushtetuta</li> <li>□ Konventat ndërkombëtare të ratifikuara</li> <li>□ Ligjet e miratuara nga Kuvendi</li> </ul> <p>Aktet normative të këshillit të Ministrave.</p>
Një rast konkret	<p>A është një vajzë nga qyteti B. Ajo është e divorcuar nga i shoqi, i cili e keqtrajtonte në mënyrë sistematike dhe mizore. A detyrohet të braktisë shtëpinë dhe fëmijët dhe të largohet nga vendi i lindjes për të gjetur mënyra të tjera jetese. Ajo largohet në mënyrë klandestine e ndihmuar nga një i panjohur i cili i paguan çmimin e udhëtimit dhe të strehimit për ditët e para, dhe gjendet e detyruar të prostitutojë në rrugët e një shteti fqinj. Trafikanti që e bleu e çoi në një shtet tjetër e kështu me radhe dore pas dore derisa gjen mundësinë e kthehet në vendin e saj. Atë e ka marrë malli për fëmijët. Ata nuk i përgjigjen dhe nuk duan ta takojnë. Ajo kërkon mbështetjen e prindërve, por ata e kanë mohuar. Ndodhet në një dilemë dhe traume të tmerrshme. E papërkrahur dhe e pasigurtë. Është një tmerr të jesh e trafikuar e të përdoresh si ajo, pa dëshirë, por një tmerr i dytë përbuzja nga të afërmit dhe fëmijët.</p>
Një rast konkret	Si mundet të ndihmojmë në një situatë të tillë?
Një rast konkret	<p>A është një vajzë 19 vjeçe, nga një fshat i rrethit X. Ajo ka lindur në një familje me shumë fëmijë. Në moshën 16 vjeç bie në dashuri me B, bashkëfshatar i saj refugjat ne Greqi dhe ikën nga shtëpia. Ata largohen në Greqi duke kaluar kufirin në rrugë të paligjshme. Me të mbërritur në Greqi B i tregon qëllimin e vërtetë të lidhjes me të. Ajo duhej të punonte dhe të fitonte për vete e për të. „Unë qave, e kundërshtova por si këmbim u rraha u keqtrajtova dhe mu tregua rruga. Me ndihmën e një shoqeje u ktheva në Shqipëri. Familja nuk më pranoi. Pas një jave trafikanti tashmë i penduar vjen me premtime dhe i premtonte martesë të lumtur. Bëjnë celebrimin e martesës dhe ajo mbetet shtatzënë. Kur i thotë se presin fëmijë ai e godet me shqelm në bark. Një abort të tmerrshëm. Ajo largohet me shume mundim dhe kërkon të lidhet me familjen e saj e të rinisë jetën nga e para e të mos lejojnë të tjerët të luajnë me të.</p>



Po ne ku jemi në këtë skemë???

**A. Trafikimi kryhet nga grupi i organizuar kriminal**

Është formë e kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar. Trafikimi mbështetet në shfrytëzim, mashtrim dhe gënjeshtër.

**B. Bëhet me qëllim rritjen në maksimum të përfitimit ekonomik****C. Trafikimi ka karakter ndërkombëtar**

Krimi i organizuar ndërkombëtar shtrihet përtej kufijve dhe nën juridiksionin e së paku dy shteteve

**A. Hyrja në proces në vendin e origjinës (Rekrutimi)**

Njerëzit e trafikuar barten **kundër vullnetit të tyre** për të marrë pjesë në veprimet **për të cilat ata nuk e kanë dhënë pëlqimin**. Në të gjitha rastet, shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të cilat i detyrojnë njerëzit të bien në duart e trafikantëve, tregojnë qartë se *viktimat kanë nevojë për mbrojtje dhe përkrahje të shtuar*.

**B. Udhëtimi nëpër vendet transite (Transportimi, transferimi, strehimi)**

Shumë viktima kurrë nuk janë larguar nga vendi i tyre dhe kështu janë plotësisht të varura nga trafikantët.

**C. Mbërritja në vendin e përcaktuar (destinuar) (pranimi, shfrytëzimi)**

Femrat, pas arritjes në vendin e përcaktuar (destinuar), jetojnë në kushte që i ngjajnë skllavërisë, kryesisht si prostituta, por gjithashtu edhe si shtëpiake, punëtore në fabrikë apo të shtrënguara të jetojnë në bashkësi martesore. Ndërkohë rreziku nga hakmarrja dhe mungesa e dokumenteve të identifikimit pengojnë shumë nga viktimat që t'i ikin keqtrajtimit. Keqtrajtimi i vazhdueshëm fizik, psikik dhe seksual i lë viktimat pa zgjidhje tjetër (alternativë).

Vini re!

Ç'është trafikimi?

- Nga pikëpamja sociale,
- Ndërsa nga pikëpamja juridike,

**Avantazhet e njohurive mbi veprën penale të trafikimit :**  
**Fokusi tek e ardhmja.**



**Çfarë duhet të dimë r???**

**Komunikimi – Arti i ndërhyrjes**

- Aftësitë e mira të komunikimit janë mjeti më me ndikim që të parandalohet fenomeni i trafikimit. Shpërndajeni këtë informacion që morët sot tek të tjerë, kudo që punoni e jetoni.

**Qëndrim profesional**

- Nënkupton qëndrimin miqësor me të trafikuarën.

**Aftësi të forta verbale dhe joverbale**

aftësitë verbale dhe joverbale kërkohen me qëllim të qetësimit potencial të situatave shpërthyes.

**Kontakti personal me viktimën kërkon njohur psikologjike, durim e përkushtim, dhembshuri e vlerësim të drejtë të situatës në të cilën ajo ndodhet.**

**Shfaqni qasje të matur dhe me respekt**

**Mos parashtroni pyetje të cilat do të nënkuptonin se ajo vet e ka zgjedhur profesionin e prostitutës ose se ajo vepron në marrëveshje me trafikantët/shfrytëzuesit**

Femrat të cilat merren me prostitucion janë të vetëdijshme për mënyrën se si shumica e qenieve njerëzore i shikon ato – se ato nuk janë të respektuara ose se nuk konsiderohen si viktima të krimit. Femrat të cilat vijnë nga kulturat ku marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, e posaçërisht ato që për motiv kanë përfitimin material konsiderohen si tepër të pandershme, do të turpërohen më shumë. Për disa nga ato do të jetë e pamundshme kthimi në familjet e tyre për shkak të asaj se çfarë u ka ndodhur.

**Provoni të nxitni viktimën që të flas për ndjenjat e saj**

**Ofroni siguri**

**Çfarë duhet të bëjë ai që ka kontakte me të trafikuarit**

- Të flasë ngadalë dhe butësisht, t’i zgjedhë me kujdes fjalët, tonin dhe metodën.
- Ta bëjë subjektin që të marrë pjesë ne komunikim, te shprehet lirshëm, duke i shtruar pyetje të hapura.
- Te përqendrojë bisedën në nivelin e arsimimit dhe fjalorit të personit.
- Të qartësojë se çfarë është duke thënë personi dhe të vërtetojë kuptimin së bashku me atë / atë duke e përmbledhur atë që është thënë.
- Të kujtojë vlerën e qetësisë e cila siguron kohë për të menduar dhe për t’i shtyrë të tjerët që ta mbushin vakuumin e qetësisë.
- Të jetë i thjeshtë. Shprehjet të jenë të shkurtra dhe të qarta, jo të lodhshme apo të ndërlikuara.

**Çfarë duhet të bëjë nuk të**

duhet t’iu shmangemi:

- bisedave te gjata, ngritjes së moralit apo dhënies së këshillave.
- Zërit të lartë
- Ritmit të lartë
- Të folurit të shpejtë
- Zërit monoton
- Gjuhës nënçmuese
- Terminologjisë së ofendimeve etnike
- Përdorimit të zhargonit jo të përshtatshëm
- Bërjes së shpejtë të pyetjeve

- a. *Kujdes në kontaktet me sy*
- b. *qëndrimi i trupit*
- c. *Largësia e përshtatshme*
- d. *Prekja*
- e. *Shfaqja e metodave zyrtare*
- f. *Te dëgjojë për ndonjë indikacion apo gjendje emocionale ose ndonjë ndryshim në disponim.*